



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 612/2 prot

Datë 12.03.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK
ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “A & T” SHA & “2A2F-L OIL” SHPK & “Gega Center GKG” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-92051-12-22-2023, me objekt: Loti 2: “*Blerje Naftë (Eurodiesel)*”, me fond limit 278,832,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 26.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë SHA.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Resuli - ER” SHA & “Kastrati” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë ekonomikë “A & T” SHA (me NIPT L32320008H) & “2A2F – L OIL” SHPK (me NIPT L41915013M) & “Gega Center GKG” SHPK (me NIPT K66801001T) dhe adresë: Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Ibrahim Rugova”, Kulla “Sky Toëer”, Kati 7, Apartamenti 3, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Ujësjellës Kanalizime Tiranë SHA, me adresë: Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133, Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027, Tiranë

Subjekte të Interesuar:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Resuli - ER” SHA (me NIPT L12510413V) & “Kastrati” SHPK (me NIPT

K21711502V) dhe adresë: Lagja 14, Rruga “Tiranës”, Ura e “Dajlanit”, Durrës

Në datën 11.03.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 612/2024 protokolli, datë 11.03.2024 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “A & T” SHA & “2A2F-L OIL” SHPK & “Gega Center GKG” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-92051-12-22-2023, me objekt: Loti 2: “*Blerje Naftë (Eurodiesel)*”, me fond limit 278,832,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 26.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë SHA.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “A & T” SHA & “2A2F-L OIL” SHPK & “Gega Center GKG” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Resuli - ER” SHA & “Kastrati” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.*”

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “A & T” SHA & “2A2F-L OIL” SHPK & “Gega Center GKG” SHPK.

Konkretisht bashkimi i operatorëve ekonomikë “A & T” SHA & “2A2F-L OIL” SHPK & “Gega Center GKG” SHPK është skualifikuar për arsyet si më poshtë vijon:

“1.Oferta e paraqitur nga Bashkimi I operatorëve ekonomik “A&T” & “2A2F-L OIL” & “Gega Center GKG” Sh.p.k me ofertë ekonomike 14.80/litër (katermbedhjete pike tetedhjete) dhe me vlere 274.706.500 (dyqind e shtatedhjete e kater million e shtateqind e gjashte mije e peseqind) leke

Se pari AK ne shtojcen I perkatesisht tek formulari i ofertes ka kerkuar si me poshte vijon:

Shenim: Çmimi do të përllogaritet bazuar në:

a) i) çmimi i bursës, sipas Reuters lëvruar sipashtit CIF-Shqipëri, i cili është publikuar në Buletinin e fundit të Njoftimeve Publike, para datës së dorëzimit dhe hapjes së ofertave;

b) elementët fiskale;

c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës

Ofertuesit së bashku me shtojcën 1.1 duhet të dorëzojnë edhe tabelën me përllogaritjet e çmimit për njësi ku evidentohet marzhi i fitimit i shprehur në vlerë absolute dhe elementët e tjerë, përfshi çmimin e bursës, premio, taksat dhe akciza.

Gjate shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur nga Bashkimi i operatoreve ekonomik "A&T" & "2A2F-L OIL" & "GEGA CENTER GKG SH.P.K Komisioni i vleresimit te ofertave konstatoj se oferta e paraqitur nga bashkimi i operatoreve te sipercitar nuk i jane permbajtur buletin e fundit te njoftimeve Publike, para datës së dorëzimit dhe hapjes së ofertave.

Ju beje me dije se duke qene se procedura e prokurimit eshte zhvilluar ne daten 26.01.2024, dhe buletini fundit eshte ai me nr 3 i dates 22.01.2024 operatoret ekonomik duhet te ofertonin me buletin e kesaj date pasi ofertimi me buletin e dates 12.01.2024 perben kusht per skualifikim. Ne keto kushte kjo oferte nuk eshte konform kriterëve te kerkuara nga AK ne dokumnetat standarte te tenderit.

Në rregullat e prokurimit publik, DST në seksionin B "Përgatitja e Ofertave" parashikohet konkretisht pika 3, dhe pika 6

3.Oferta do të përmbajë të gjitha dokumentet mbështetëse siç kërkohet nga Autoriteti/Enti kontraktor.

6. 1 Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në në Formularin e Ofertës do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuar në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit.

Në DST parashikohet shprehimisht Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 80, neni 92/3 të Ligjit 162/2020, date 23.12.2020, për "Prokurimin Publik", dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" Neni 79, neni 80, neni 82 e shpall të pavlefshme ofertën e operatorit ekonomik pasi nuk ka përmbushur kushtet e kërkuar në DST si dhe ka ndryshuar sasinë e mallrave të kërkuara nga AK."

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat bashkimi i operatorëve ekonomikë "A & T" SHA & "2A2F-L OIL" SHPK & "Gega Center GKG" SHPK pretendon se nuk përmbushen nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "Resuli - ER" SHA & "Kastrati" SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht si më poshtë:

Loti 2: "Blerje Naftë (Eurodiesel)

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar; (lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore

për vitin 2023), në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësisve vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

*2.3.10. Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi apo me qera minimumi 2 mjete (autobot) me kapacitet mbajtës deri në 1000 l **secila** dhe 1(një)mjet autobot me kapacitet mbajtës deri në 5000 litra.*

Për të vërtetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Për këto mjete që shënohen në regjistra publikë në rastin e pronësisë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), certifikatën për transportin e mallrave të rrezikshme, pasaportën e autobotit ,certifikatën e mbrojtjes nga zjarri dhe certifikaten e verifikimit te kontaltrit te leshuar nga DPM dhe per mjetet e siguruara me qera, kontratën e qerasë (e vlefshme) shoqëruar me dokumentin qe verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), certifikatën për transportin e mallrave të rrezikshme, pasaportën e autobotit ,certifikatën e mbrojtjes nga zjarri dhe certifikaten e verifikimit te kontaltrit te leshuar nga DPM .

Shënim: *Për pikat e mësipërme operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.*

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: *Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit** , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 12.03.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri